Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde
20/2026

Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese



Autorët: Naim Jakaj dhe Gzim Shala

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Ambasadës Gjermane në Kosovë.

Implementuar nga:

KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVES PER DREJTESI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

Financuar nga:

Ambasada
e Republikës Federale të Gjermanisë
Prishtinë

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD
Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Nëntor 2026
Prishtinë, Republika e Kosovës

Lista e shkurtesave

AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit

AKP – Agjencia Kosovare e Pronës

CCJE – Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë

GjEDNj – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

IKD – Instituti i Kosovës për Drejtësi

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive 7
2. Qëllimi dhe arsyetimi i nismës legjislative 8
2.1. E drejta për nismë legjislative qytetare 9
2.2. Qëllimi i dokumentit dhe problemi që synohet të adresohet 9
3. Fuqia juridike e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe pasojat për mos zbatim 10
3.1. Roli i Gjykatës Kushtetuese në rendin kushtetues 10
3.2. Detyrueshmëria e vendimeve sipas Kushtetutës 11
3.3. Korniza aktuale penale dhe hendeku normativ 11
4. Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në Kosovë 12
4.4.1 K186/18 – Slavica Dordevic 13
4.4.2 KI08/09 – Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut – IMK Ferizaj 13
4.4.3 KI90/16 – Branislav Jokić 14
4.4.4 KI112/12 – Adem Meta 14
4.4.5 KI187/13 – N. Jovanovic 15
4.4.6 KI56/09 – Fadil Hoxha dhe të tjerët 16
4.4.7 - KO 01/09 - Qemajl Kurtishi 16
4.4.8 KO79/23 – Ligji për Pagat 17
4.4.9 KO124/25 – Konstituimi i Kuvendit dhe veprimet e Kryesuesit të Seancës Konstituive 17
5. Pasojat e moszbatimit të akgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese 18
5.1. Rendi kushtetues 18
5.2. Siguria juridike 19
5.3. Besimi i qytetarëve 19
5.4. Përgjegjësia institucionale 20
6. Standardet ndërkombëtare dhe praktikat krahasuese 20
6.1. Standardet ndërkombëtare 20
6.2. Praktika evropiane 23
6.3. Praktika rajonale 24
7. Nevoja për ndryshimin e Kodit Penal 25
8. Ndikimet e pritshme 27
8.1. Ndikimet në sundimin e ligjit 27
8.2. Ndikimet në funksionimin e institucioneve 27
8.3. Ndikimet në zbatimin e Kushtetutës 28
8.4. Ndikimet në besimin e qytetarëve 28

1. Përmbledhje ekzekutive

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe personat në Republikën e Kosovës. Megjithatë, praktika ka treguar se një vendim i Gjykatës Kushtetuese jo gjithmonë përfundon me zbatimin e tij. Në raste të caktuara, qytetarët kanë fituar rastin para Gjykatës Kushtetuese, por kanë vazhduar të presin me vite që vendimi të zbatohet. Në raste të tjera, institucionet publike nuk kanë ndërmarrë veprimet që Gjykata ua ka kërkuar.

Ky është problem që shkon përtej një rasti tw njw indiviti tw caktuar. Nëse një institucion mund të zgjedhë nëse do ta zbatojë ose jo një vendim të Gjykatës Kushtetuese, atëherë vihet në pikëpyetje vetë autoriteti i Kushtetutës. Vendimet e kësaj Gjykate nuk janë rekomandime, ashtu sicc nuk janw rekomandime vendimet e gjykatave tw rregullta. Ato vendime përcaktojnë përfundimisht se çfarë kërkon Kushtetuta dhe institucionet nuk kanë diskrecion për t'i shpërfillur detyrimet që burojnë prej tyre.

Analiza e rasteve të trajtuara në këtë raport tregon se moszbatimi nuk është vetëm problem nw nivelin teorik. Në disa raste, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se aktgjykimet e saj nuk janë zbatuar dhe ka njoftuar edhe Prokurorin e Shtetit. Në raste të tjera, zbatimi është vonuar ose detyrimet e përcaktuara nga Gjykata nuk janë përmbushur plotësisht. Pasojat i bartin qytetarët, por edhe vetë rendi kushtetues. Nw kwtw mwnyrw, dobësohet siguria juridike, përgjegjësia e institucioneve dhe besimi se një vendim përfundimtar do të prodhojë efekt në praktikë.

Problemi bëhet edhe më i rëndësishëm për shkak të një paqartësie në legjislacionin penal. Kodi Penal e sanksionon mosekzekutimin e vendimeve të gjykatave, por nuk e përmend shprehimisht moszbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Duke qenë se Gjykata Kushtetuese ka pozitë të veçantë dhe nuk është pjesë e sistemit të gjykatave të rregullta, kjo krijon paqartësi lidhur me përgjegjësinë penale të personave që qëllimisht refuzojnë t'i zbatojnë vendimet e saj.

Pikërisht këtë boshllëk synon ta adresojë nisma legjislative qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal. Qëllimi nuk është që çdo vonesë në zbatimin e një vendimi të shndërrohet në vepër penale. Mund të ketë raste kur zbatimi kërkon kohë, veprime përgatitore ose kur ekziston një pamundësi objektive. Përgjegjësia penale duhet të kufizohet në rastet kur personi përgjegjës ka detyrimin juridik, kompetencën dhe mundësinë reale për ta zbatuar vendimin, por qëllimisht dhe pa arsyetim të ligjshëm nuk e bën këtë.

Standardet ndërkombëtare nuk kërkojnë kriminalizimin e çdo moszbatimi, por mekanizma efektivë dhe përgjegjësi sipas rrethanave, përfshirë masa disiplinore, civile ose penale. E drejta penale duhet të mbetet mjeti i fundit dhe të përdoret vetëm kur është e nevojshme dhe proporcionale.

Prandaj, propozimi i këtij raporti është i drejtpërdrejtë. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese duhet të zbatohen, ndërsa refuzimi i qëllimshëm dhe i pajustifikuar për zbatimin e tyre duhet të ketë përgjegjësi të qartë ligjore.

2. Qëllimi dhe arsyetimi i nismës legjislative

Nisma legjislative qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal synon vendosjen e përgjegjësisë penale për moszbatimin e qëllimshëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga personat përgjegjës për zbatimin e tyre. Nevoja për këtë ndërhyrje buron nga rëndësia e këtyre vendimeve për funksionimin e rendit kushtetues dhe funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe detyruese dhe zbatimi i tyre nuk mund të varet nga vullneti i institucionit apo personit të cilit i drejtohen.

Shtetet me demokraci funksionale dhe stabilitet në qeverisje e kane tejkaluar kërcënimin penal si formë të zbatimit të vendimeve të gjykatës kushtetuese. Pothuajse, në shumicën e demokracive të konsoliduara Presidenti, Kryeministri, Parlamenti apo një institucion tjetër publik respekton autoritetin e Gjykatës Kushtetuese dhe duke ndërtuar kulturën politike ku vendimet e kesaj gjykate zbatohen.

Në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë kultura e respektimit të vendimeve të gjykatës kushtetuese nuk është zhvilluar. Viteve të fundit me theks të veccantë shumica politike që merr pushtetin nga zgjedhjet, cakton kufij të pushtetit që dalin jashtë Kushtetute dhe praktikës së gjyqësisë kushtetuese. Demokracia funksionon vetëm në rastet kur fituesit e zgjedhjeve pranojnë se edhe pushteti i fituar përmes zgjedhjeve demokratike ka kufij dhe kur kymirëbesim humbet, shteti detyrohet të fillojë të shkruajë në Kodin Penal atë që në një demokraci të konsoliduar do të duhej të ishte e panevojshme të shkruhej.

Legjislacioni penal në fuqi nuk e adreson shprehimisht moszbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Neni 394 i Kodit Penal përcakton përgjegjësi penale për mosekzekutimin e vendimeve të gjykatave, por nuk i përfshin vendimet e Gjykatës Kushtetuese, e cila nuk është pjesë e sistemit të gjykatave të rregullta. Në këtë aspekt, ekziston një hapësirë në kuadrin aktual penal, pasi nuk përcaktohet shprehimisht përgjegjësia penale për personat përgjegjës që qëllimisht refuzojnë ose nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Qëllimi i nismës nuk është penalizimi i çdo vonese apo vështirësie objektive në zbatim. Përgjegjësia penale synohet për rastet kur moszbatimi është i qëllimshëm dhe i pajustifikuar, ndërsa personi përgjegjës ka detyrim juridik, kompetencë dhe mundësi reale për ta zbatuar vendimin. Në këtë mënyrë, përgjegjësia penale do të individualizohej dhe do të zbatohej vetëm në rastet kur ekziston refuzim apo shmangie e vetëdijshme nga përmbushja e një detyrimi kushtetues.

Në thelb, nisma nuk e ka për qëllim ndëshkimin penal si qëllim në vetvete, por garantimin e zbatimit efektiv të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe mbrojtjen e autoritetit të tyre. Përcaktimi i qartë i përgjegjësisë penale synon të parandalojë situatat në të cilat zbatimi i një vendimi kushtetues trajtohet si çështje e vullnetit institucional. Në këtë mënyrë, ndryshimi i propozuar synon të forcojë epërsinë e Kushtetutës, sundimin e ligjit, përgjegjësinë institucionale dhe sigurinë juridike.

2.1. E drejta për nismë legjislative qytetare

E drejta e qytetarëve për nismë legjislative është e garantuar drejtpërdrejt me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Neni 79 i Kushtetutës përcakton se, krahas Presidentit, Qeverisë dhe deputetëve të Kuvendit, nismën për të propozuar ligje mund ta ndërmarrin edhe së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Kjo e drejtë është konkretizuar me Ligjin për Nismën Legjislative[1], i cili përcakton rregullat dhe procedurat për ushtrimin e saj. Sipas nenit 5 të këtij ligji, nismë legjislative mund të ndërmarrin së paku 10.000 qytetarë me të drejtë vote, duke u mundësuar qytetarëve që përmes një procedure të përcaktuar ligjore të propozojnë drejtpërdrejt ndryshime apo plotësime të legjislacionit.

Edhe Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në nenin 70[2], e njeh të drejtën e së paku 10.000 qytetarëve për të propozuar projektligj në Kuvend. Kështu, nisma legjislative qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal mbështetet në një bazë të qartë kushtetuese, ligjore dhe procedurale, përmes së cilës qytetarët marrin pjesë drejtpërdrejt në procesin ligjvënës.

2.2. Qëllimi i dokumentit dhe problemi që synohet të adresohet

Ky dokument synon të analizojë problemin e moszbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe nevojën për krijimin e një mekanizmi të qartë të përgjegjësisë penale për rastet kur personat përgjegjës qëllimisht nuk i zbatojnë ato. Në këtë drejtim, dokumenti trajton kuadrin aktual juridik, praktikën e deritanishme të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe arsyet që justifikojnë ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal.

Problemi që synohet të adresohet lidhet me faktin se, përkundër karakterit përfundimtar dhe detyrues të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, në praktikë janë evidentuar raste të moszbatimit ose vonesave të konsiderueshme në zbatimin e tyre. Mungesa e pasojave efektive ndaj personave përgjegjës për moszbatim rrezikon që respektimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të varet nga vullneti i institucioneve dhe jo nga detyrimi kushtetues për zbatimin e tyre.

Në të njëjtën kohë, Kodi Penal sanksionon mosekzekutimin e vendimeve të gjykatave, por nuk e përcakton shprehimisht përgjegjësinë penale për moszbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo është veçanërisht relevante duke pasur parasysh pozitën e veçantë kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese, e cila nuk është pjesë e sistemit të gjykatave të rregullta.

---

[1] Ligji Nr. 04/L-025 për Nisma Legjislative, nenet 1, 2 dhe 5, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 23, 26 tetor 2011.
[2] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 70, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4.

Për rrjedhojë, legjislacioni aktual nuk përcakton përgjegjësinë penale për rastet kur personat përgjegjës qëllimisht refuzojnë ose nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Dokumenti synon të argumentojë nevojën për adresimin e kësaj çështjeje përmes një dispozite të qartë dhe të parashikueshme penale. Përgjegjësia penale nuk synohet për çdo vonesë apo pamundësi objektive në zbatim, por për moszbatimin e qëllimshëm dhe të pajustifikuar, kur personi përgjegjës ka detyrim juridik, kompetencë dhe mundësi reale për zbatimin e vendimit. Në këtë mënyrë synohet të forcohet zbatimi efektiv i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe, përmes tyre, respektimi i Kushtetutës dhe sundimit të ligjit.

3. Fuqia juridike e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe pasojat për mos zbatim

Fuqia juridike e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese buron drejtpërdrejt nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 116 përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Kushtetuta përcakton gjithashtu se vendimet e Gjykatës publikohen në Gazetën Zyrtare, ndërsa shfuqizimi i ligjit, aktit ose veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit, përveç nëse Gjykata ka përcaktuar ndryshe.

Ligji për Gjykatën Kushtetuese e konkretizon më tej efektin juridik të vendimeve. Sipas nenit 20, vendimet e Gjykatës duhet të jenë të shkruara dhe të arsyetuara, u dërgohen palëve sipas detyrës zyrtare dhe publikohen në Gazetën Zyrtare. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit, përveç nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar ndryshe. Këto dispozita e bëjnë të qartë se zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim juridik dhe jo çështje e vullnetit të institucioneve apo personave përgjegjës.

Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese cenon autoritetin e saj, epërsinë e Kushtetutës, sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike. Megjithatë, kuadri aktual penal nuk përcakton shprehimisht përgjegjësinë penale për moszbatimin e qëllimshëm të këtyre vendimeve. Për këtë arsye, nisma legjislative synon që rastet kur personi përgjegjës, pavarësisht detyrimit dhe mundësisë për zbatim, qëllimisht dhe pa arsye të justifikueshme nuk e zbaton vendimin, të shoqërohen me përgjegjësi të qartë penale.

3.1. Roli i Gjykatës Kushtetuese në rendin kushtetues

Gjykata Kushtetuese ka rol qendror në mbrojtjen e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 112 të Kushtetutës[3], ajo është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe për vlerësimin e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, si dhe është plotësisht e pavarur në ushtrimin e përgjegjësive të saj.[1] Përmes kësaj kompetence, Gjykata garanton epërsinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera juridike dhe ushtron kontrollin

[3] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, paragrafët 1 dhe 2.

përfundimtar mbi kushtetutshmërinë e tyre. Vendimet e saj, si rezultat i këtij pozicioni kushtetues, përbëjnë përcaktimin përfundimtar institucional dhe juridik për çështjet kushtetuese që i nënshtrohen shqyrtimit të saj.

Megjithatë, roli i Gjykatës si autoritet përfundimtar nuk nënkupton se vetëm ajo e interpreton Kushtetutën. Institucionet publike e interpretojnë dhe zbatojnë Kushtetutën gjatë ushtrimit të përditshëm të kompetencave të tyre. Dallimi qëndron në faktin se Gjykata Kushtetuese ka fjalën përfundimtare institucionale për kuptimin dhe zbatimin e Kushtetutës kur një çështje kushtetuese paraqitet para saj. Për këtë arsye, interpretimi i dhënë nga Gjykata në një vendim përfundimtar nuk mund të zëvendësohet ose rishikohet nga një institucion tjetër shtetëror.

Në një rend kushtetues demokratik, roli i Gjykatës Kushtetuese shkon përtej zgjidhjes së një kontesti juridik konkret. Ajo shërben si garantuese e kufijve të ushtrimit të pushtetit, duke siguruar që asnjë institucion dhe asnjë shumicë politike të mos e ushtrojë autoritetin publik përtej kufijve të përcaktuar me Kushtetutë. Në këtë kuptim, autoriteti i Gjykatës Kushtetuese është një nga mekanizmat përmes të cilëve epërsia e Kushtetutës shndërrohet nga një parim formal në një kufizim real të pushtetit. Prandaj, respektimi i vendimeve të saj nuk lidhet vetëm me autoritetin e Gjykatës si institucion, por me respektimin e vetë rendit kushtetues dhe të parimit se çdo pushtet publik buron nga Kushtetuta dhe ushtrohet brenda kufijve të saj.

3.2. Detyrueshmëria e vendimeve sipas Kushtetutës

Detyrueshmëria e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese buron drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Përmes vendimeve të saj, Gjykata jep interpretimin përfundimtar të normave kushtetuese dhe përcakton mënyrën se si ato duhet të kuptohen dhe zbatohen nga institucionet publike. Në këtë kuptim, aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, për nga fuqia juridike, janë ekuivalente me normën kushtetuese, pasi përmbajtja e tyre përcakton kuptimin përfundimtar dhe detyrues të Kushtetutës në çështjen e shqyrtuar.

Ky efekt juridik nënkupton se institucionet nuk kanë diskrecion për të vendosur nëse do t'i zbatojnë ose jo detyrimet që burojnë nga një aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese. Kur Gjykata konstaton një shkelje kushtetuese dhe përcakton një detyrim konkret për një institucion, mosveprimi apo refuzimi për përmbushjen e atij detyrimi nuk përbën vetëm moszbatim të një vendimi gjyqësor, por cenim të vetë detyrimit kushtetues. Për këtë arsye, detyrueshmëria e aktgjykimeve është pjesë e funksionimit të parimit të epërsisë së Kushtetutës.

Rrjedhimisht, respektimi i Kushtetutës dhe zbatimi i aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra. Nëse një institucion do të mund të refuzonte zbatimin e interpretimit përfundimtar të Kushtetutës pa pasoja, atëherë edhe vetë epërsia e Kushtetutës do të humbiste efektin e saj praktik. Pikërisht për këtë arsye, moszbatimi i qëllimshëm i aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese duhet të kuptohet jo vetëm si mosrespektim i autoritetit të Gjykatës, por si cenim i rendit kushtetues që ajo ka mandat ta mbrojë.

3.3. Korniza aktuale penale dhe hendeku normativ

Neni 394 i Kodit NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës e ka inkriminuar si vepër të veçantë penale mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Sipas këtij neni:

> 1. Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili refuzon të ekzekutoj urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm të ndonjë gjykate të Republikës së Kosovës apo i cili nuk e ekzekuton vendimin brenda afatit ligjor apo afatit të caktuar me vendim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
> 2. Nëse me veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni është shkaktuar shkelje e rëndë e të drejtave njerëzore apo dëm substancial material, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
> 3. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni e ekzekuton vendimin e plotfuqishëm të gjykatës, ndjekja nuk do të ndërmerret.

Përkundër faktit se në elementet e veprës penale ky nen i referohet "ndonjë gjykate të Republikës së Kosovës", kjo fjali nuk përfshinë aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Përkundër faktit se Gjykata Kushtetuese mbanë emrin "Gjykatë", në realitet, ajo nuk është një Gjykatë e rregullt.

Në nenin 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku është qartësuar forma e qeverisjes dhe ndarja e pushtetit, bëhet më se i qartë ky dallim. Sipas paragrafit 5 të këtij neni "Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat". Ndërkaq, në këtë paragraf nuk hyn Gjykata Kushtetuese, e cila rregullohet me paragrafin pasues, që thekson se "Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës". Gjykatat e rregullta janë të rregulluara me Ligjin NR. 06/L-054 për Gjykatat, derisa Gjykata Kushtetuese është e rregulluar me Ligjin NR.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese.

Kështu, kjo normë penale përfshinë të gjitha vendimet gjyqësore të gjyqësorit të rregullt, por hendeku qëndron në mos mbulueshmërinë e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese përmes kësaj norme.

4. Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në Kosovë

Nga gjetjet e trajtuara rezultojnë 10 raste në të cilat zbatimi i aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese është shoqëruar me probleme, vonesa ose mosveprim tw institucioneve. Rastet janë të natyrave të ndryshme dhe prekin të drejtat pronësore, marrëdhënien e punës dhe pagat, të drejtën për gjykim të drejtë dhe mbrojtje efektive gjyqësore, pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, të drejtat e komuniteteve joshumicë, si dhe funksionimin kushtetues të Kuvendit.

Institucionet ndaj të cilave janë drejtuar detyrimet përfshijnë Qeverinë, Kuvendin e Kosovës, gjykatat e rregullta, Agjencinë Kosovare të Privatizimit/Agjencinë Kosovare të Pronës dhe komunat, ndërsa në rastin e konstituimit të Kuvendit detyrimet janë adresuar edhe drejtpërdrejt ndaj deputetëve dhe Kryesuesit të Seancës Konstituive. Veçanërisht shqetësues është fakti se

problemet me zbatimin nuk paraqiten si dukuri e izoluar në një institucion apo në një periudhë të vetme, por shtrihen ndër vite dhe në nivele të ndryshme të pushtetit. Në disa raste Gjykata ka nxjerrë edhe Aktvendime për Mospërmbarim, ndërsa në disa të tjera ka njoftuar Prokurorin e Shtetit.

4.4.1 K186/18 – Slavica Dordevic

Rasti KI86/18 ishte iniciuar nga Slavica Đorđević, e cila kundërshtoi vendimet e gjykatave të rregullta që lidhen me përmbarimin e një vendimi të formës së prerë për kthimin në posedim të një prone në Prizren. Gjykata Kushtetuese, më 3 shkurt 2021, konstatoi shkelje të të drejtave të saj kushtetuese dhe përcaktoi se vendimi i Komisionit për Çështje Pronësore Banesore i vitit 2005 dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren i vitit 2011 ishin vendime të formës së prerë që duhej të përmbaroheshin nga autoritetet publike përgjegjëse.[4] Gjykata urdhëroi Gjykatën Themelore në Prizren që deri më 3 maj 2021 ta njoftonte për masat e ndërmarra për zbatim.

Megjithatë, zbatimi i aktgjykimit nuk u konfirmua. Pas kërkesave të përsëritura për informacion dhe pas kalimit të më shumë se dy vjetëve, Gjykata Kushtetuese, më 13 shkurt 2024, konstatoi njëzëri se aktgjykimi KI86/18 nuk ishte zbatuar. Për këtë arsye, ajo nxori Aktvendim për Mospërmbarim[5], vendosi publikimin e tij dhe njoftimin e Prokurorit të Shtetit për moszbatimin e vendimit.[6]

4.4.2 KI08/09 – Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut – IMK Ferizaj

Rasti KI08/09 ishte iniciuar nga Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut – IMK Ferizaj, lidhur me moszbatimin e një aktgjykimi të Gjykatës Komunale në Ferizaj të vitit 2002, i cili kishte njohur të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe kompensimin e pagave të papaguara për 572 punonjës. Më 17 dhjetor 2010, Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe efektiv, duke vlerësuar se një vendim gjyqësor përfundimtar nuk mund të mbetet i pazbatuar.[7] Ajo përcaktoi se vendimi i formës së prerë i Gjykatës Komunale duhej të përmbarohej nga organet kompetente, në veçanti nga Qeveria e Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

---

[4] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin KI86/18, Slavica Đorđević, 3 shkurt 2021, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/ki-_86_18_agj_shq.pdf)

[5] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktvendim për Mospërmbarim në rastin KI86/18, Slavica Đorđević, 13 shkurt 2024, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/ki_86_18_vmsp_shq.pdf).

[6] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Njoftim për Kryeprokurorin e Shtetit lidhur me moszbatimin e Aktgjykimit në rastin KI86/18, Slavica Đorđević, 8 mars 2024, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/ki_86_18_vmsp_shq.pdf)

[7] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin KI08/09, Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut – IMK Ferizaj, 17 dhjetor 2010, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/gjk_ki_08_09_shq.pdf)

Megjithatë, aktgjykimi nuk u zbatua. Pas kërkesave për informacion drejtuar institucioneve përgjegjëse dhe mungesës së përmbarimit, Gjykata Kushtetuese nxori më 18 tetor 2012 Vendim për Mospërmbarim[8], duke konstatuar se Qeveria dhe AKP-ja nuk e kishin përmbaruar aktgjykimin. Moszbatimi vazhdoi edhe në vitet pasuese dhe, më 28 maj 2019, Gjykata e njoftoi Kryeprokurorin e Shtetit, duke theksuar se mosekzekutimi i vendimeve të saj përbën shkelje kushtetuese dhe duke kërkuar ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme në kuadër të kompetencave të Prokurorisë.[9]

4.4.3 KI90/16 – Branislav Jokić

Rasti KI90/16 ishte iniciuar nga Branislav Jokić, për shkak të moszbatimit të vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës të vitit 2014, me të cilin atij i ishte njohur e drejta e posedimit mbi një pronë në Pejë. Më 5 dhjetor 2017, Gjykata Kushtetuese konstatoi se moszbatimi i këtij vendimi të formës së prerë kishte cenuar të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën e pronës dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.[10] Gjykata shpalli të pavlefshëm vendimin e Kuvendit Komunal të Pejës që kishte ndërhyrë në të drejtën pronësore dhe përcaktoi se vendimi i Komisionit duhej të përmbarohej, duke kërkuar që brenda gjashtë muajve të njoftohej për masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit.

Pavarësisht se në vitin 2019 ishte konfirmuar riposedimi i pronës, Jokić e njoftoi Gjykatën se Komuna e Pejës nuk e kishte zbatuar plotësisht aktgjykimin, pasi prona nuk ishte regjistruar në emrin e tij në kadastër. Pas kërkesave drejtuar Komunës dhe mungesës së konfirmimit për zbatim të plotë, më 18 korrik 2022, Gjykata Kushtetuese konstatoi njëzëri se, edhe pas katër vjetësh, aktgjykimi nuk ishte zbatuar plotësisht dhe nxori Aktvendim për Mospërmbarim.[11] Për këtë moszbatim, Gjykata e njoftoi edhe Prokurorin e Shtetit, duke theksuar se i takon Prokurorisë të ndërmarrë veprimet e mëtejme sipas autorizimeve ligjore.[12]

4.4.4 KI112/12 – Adem Meta

Rasti KI112/12 ishte iniciuar nga Adem Meta, i cili kërkoi realizimin e së drejtës për kthim në vendin e punës dhe zbatimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, pasi gjykatat e

---

[8] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vendim për Mospërmbarim në rastin KI08/09, Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut – IMK Ferizaj, 14 nëntor 2012, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/gjk_ki_08_09_vmsp_shq.pdf)

[9] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Njoftim për Kryeprokurorin e Shtetit për moszbatimin e Aktgjykimit në rastin KI08/09, 28 maj 2019, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/KI08-09_Njoftim-p%C3%ABr-moszbatim-t%C3%AB-Aktgjykimit-t%C3%AB-Gjykat%C3%ABs-Kushtetuese_P.SH_.pdf).

[10] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin KI90/16, Branislav Jokić, 5 dhjetor 2017, publikuar më 28 dhjetor 2017, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15773).

[11] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktvendim për Mospërmbarim në rastin KI90/16, Branislav Jokić, 18 korrik 2022, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/ki_90_16_vmsp_shq.pdf)

[12] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Njoftim për Kryeprokurorin e Shtetit për moszbatimin e Aktgjykimit në rastin KI90/16, Branislav Jokić, 2 gusht 2022, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/KI90_16_Njoftimi-p%C3%ABr-Kryeprokurorin_shq.pdf).

rregullta kishin refuzuar përmbarimin e pjesës që lidhej me kthimin e tij në punë. Më 5 korrik 2013, Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.[13] Ajo e ktheu për rishqyrtim vendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe urdhëroi Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj që ta rishqyrtonte çështjen në përputhje me aktgjykimin dhe ta njoftonte Gjykatën Kushtetuese për masat e ndërmarra për zbatimin e tij.

Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk nxori Aktvendim të veçantë për Mospërmbarim. Megjithatë, pasi nuk kishte marrë asnjë përgjigje nga Gjykata Themelore në Mitrovicë për hapat e ndërmarrë në zbatimin e aktgjykimit, më 17 prill 2014 ajo i kërkoi kryetares së kësaj gjykate që brenda 15 ditësh ta njoftonte për zbatimin. Në të njëjtën ditë, Gjykata Kushtetuese e njoftoi edhe Kryeprokurorin e Shtetit[14] për moszbatimin e Aktgjykimit KI112/12, duke ia përcjellë shkresën drejtuar Gjykatës Themelore.

4.4.5 KI187/13 – N. Jovanovic

Rasti KI187/13 ishte iniciuar nga N. Jovanović, për shkak të moszbatimit të vendimeve përfundimtare me të cilat asaj i ishte njohur e drejta pronësore mbi një pronë në Prishtinë dhe ishte urdhëruar lirimi i saj nga personi që e shfrytëzonte. Më 1 prill 2014, Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të nenit 31, nenit 46 dhe nenit 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.[15] Gjykata urdhëroi që vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës i 22 qershorit 2011 të përmbarohej nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) dhe që kjo e fundit, brenda tre muajve, ta informonte Gjykatën për masat e ndërmarra.

Megjithatë, aktgjykimi nuk u zbatua brenda afatit, ndërsa AKP-ja arsyetoi se mungesa e mjeteve financiare e pengonte prishjen e strukturave të paligjshme në pronë. Më 6 shkurt 2015, Gjykata konstatoi se nuk kishte indikacione se aktgjykimi ishte përmbaruar dhe e njoftoi ushtruesin e detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për moszbatimin e Aktgjykimit KI187/13. Në njoftim, Gjykata theksoi se refuzimi i zbatimit të vendimeve të saj përbën shkelje të nenit 116 të Kushtetutës dhe iu referua edhe dispozitës së atëhershme penale për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, duke e ftuar Prokurorin e Shtetit të ndërmarrë veprimet e duhura ndaj përgjegjësve për moszbatim.[16]

---

[13] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin KI112/12, Adem Meta, 5 korrik 2013, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/KI112-12_Aktgjykim_SHQ.pdf).
[14] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Njoftim përkitazi me moszbatimin e Aktgjykimit në rastin KI112/12, Adem Meta, 17 prill 2014, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/KI112-12_Njoftim-perkitazi-me-moszbatimin-e-Aktgjykimit_P.SH_SHQ.pdf).
[15] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin KI187/13, N. Jovanović, 16 prill 2014, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/gjkk_ki_187_13_shq.pdf).
[16] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Informim për ushtruesin e detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për moszbatimin e Aktgjykimit në rastin KI187/13, N. Jovanović, 6 shkurt 2015, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/njoftimi_p%C3%ABr_moszbatimin_e_aktgjykimit_KI187_13_shq.pdf).

4.4.6 KI56/09 – Fadil Hoxha dhe të tjerët

Rasti KI56/09 ishte iniciuar nga Fadil Hoxha dhe 59 banorë të tjerë të Prizrenit, të cilët kundërshtuan vendimin e Kuvendit Komunal të Prizrenit për ndryshimin e Planit Urban për lagjen Jaglenica, tani Dardania. Më 22 shtator 2010, Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të nenit 52(2) të Kushtetutës[17], pasi ndryshimi i planit ishte miratuar pa diskutim publik ose ndonjë formë tjetër të pjesëmarrjes së publikut, duke ua mohuar banorëve mundësinë për t'u dëgjuar për një çështje që ndikonte në mjedisin ku jetonin. Gjykata kërkoi nga Kuvendi Komunal i Prizrenit që brenda gjashtë muajve ta njoftonte për masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit.

Megjithatë, edhe pse Komuna kishte ndërprerë punimet në objektin kontestues, aktgjykimi nuk u zbatua plotësisht. Pas më shumë se dhjetë vjetësh dhe kërkesave të përsëritura për informacion, më 22 shtator 2021, Gjykata Kushtetuese konstatoi njëzëri se aktgjykimi KI56/09 nuk ishte zbatuar, pasi autoritetet përgjegjëse nuk kishin ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e plotë të tij.[18] Për këtë arsye, Gjykata nxori Aktvendim për Mospërmbarim dhe vendosi që për moszbatimin të njoftohej Prokurori i Shtetit.[19]

4.4.7 - KO 01/09 - Qemajl Kurtishi

Rasti KO01/09 ishte iniciuar nga Qemajl Kurtishi, në cilësinë e Zëvendëskryesuesit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Prizrenit, i cili kundërshtoi nenin 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit lidhur me emblemën komunale. Më 18 mars 2010, Gjykata Kushtetuese konstatoi se ishin shkelur të drejtat e komuniteteve joshumicë për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre dhe se neni 7 i Statutit nuk ishte në përputhje me Kushtetutën, në veçanti me nenet 3, 7.1, 58 dhe 59.[20] Gjykata urdhëroi Komunën e Prizrenit që, brenda tre muajve nga dorëzimi i aktgjykimit, të ndryshonte Statutin dhe emblemën në mënyrë që t'i sillte ato në përputhje me Kushtetutën dhe të mos përjashtoheshin komunitetet joshumicë.

Para skadimit të këtij afati, Gjykata i tërhoqi vëmendjen Komunës se afati për ndryshimin e Statutit dhe emblemës përfundonte më 18 qershor 2010[21] dhe kërkoi informacion për hapat e

---

[17] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin KI56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, 22 dhjetor 2010, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/gjk_56_09_shq.pdf).

[18] . Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktvendim për Mospërmbarim në rastin KI56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë, 24 shtator 2021, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/ki56-09_VPM_shq.pdf).

[19] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Informim për Kryeprokurorin e Shtetit lidhur me moszbatimin e Aktgjykimit në rastin KI56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë, 24 shtator 2021, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/Informim-p%C3%ABr-mosp%C3%ABrmbarim-t%C3%AB-Aktgjykimit_Aleksander-Lumezi_shq.pdf).

[20] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin KO01/09, Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit, 18 mars 2010, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/ko_01_09_vendimi_al.pdf).

[21] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Letër drejtuar Kryetarit të Komunës së Prizrenit lidhur me zbatimin e Aktgjykimit në rastin KO01/09, Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit, (qasur për herë të

ndërmarrë. Komuna e Prizrenit e pranoi përgjegjësinë për zbatimin dhe kërkoi edhe 60 ditë shtesë, duke njoftuar se kishte ndërmarrë masa përgatitore. Gjykata, duke marrë parasysh këtë kërkesë dhe përpjekjet e raportuara, vendosi më 18 qershor 2010 ta zgjaste afatin edhe për tre muaj dhe kërkoi që Komuna ta njoftonte sërish për përparimin.[22]

4.4.8 KO79/23 – Ligji për Pagat

Rasti KO79/23 ishte iniciuar nga Avokati i Popullit, i cili kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Në mesin e çështjeve të kontestuara ishte edhe përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për pesëmbëdhjetë vitet e para, nga 0.5% në 0.25% për çdo vit të plotë pune. Gjykata Kushtetuese konstatoi se ky përgjysmim kufizonte të drejtat dhe liritë themelore pa ndjekur ndonjë qëllim legjitim dhe se paragrafi 6 i nenit 6 të Ligjit ishte në kundërshtim me të drejtën e pronës të garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata nuk e shfuqizoi menjëherë këtë dispozitë, por e urdhëroi Kuvendin e Kosovës që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e Aktgjykimit ta ndryshonte dhe plotësonte atë në pajtim me Kushtetutën dhe Aktgjykimin. Aktgjykimi hyri në fuqi më 1 shkurt 2024, që nënkuptonte se afati për Kuvendin përfundonte më 1 gusht 2024.[23]

Megjithatë, ky detyrim nuk u përmbush brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese dhe dispozita për shtesën e përvojës së punës nuk u ndryshua sipas urdhrit të saj. Si pasojë, zyrtarët publikë vazhduan të afektoheshin nga përgjysmimi i shtesës për pesëmbëdhjetë vitet e para të përvojës së punës, efekt të cilin vetë Gjykata kishte konstatuar se Ligji e kishte prodhuar që nga hyrja e tij në fuqi. Për dallim nga rastet e tjera të trajtuara në këtë kapitull, deri në këtë fazë Gjykata Kushtetuese nuk ka nxjerrë Aktvendim për Mospërmbarim për KO79/23 dhe as nuk ka njoftuar Prokurorin e Shtetit për moszbatimin e tij. Për këtë arsye, rasti paraqet një detyrim kushtetues për të cilin afati i përcaktuar në Aktgjykim ka kaluar, por pa një konstatim të mëvonshëm formal të Gjykatës për mospërmbarim.

4.4.9 KO124/25 – Konstituimi i Kuvendit dhe veprimet e Kryesuesit të Seancës Konstituive

Në rastin KO124/25, Gjykata Kushtetuese fillimisht konstatoi se Seanca Konstituive e Kuvendit, e filluar më 15 prill 2025, nuk kishte përfunduar dhe urdhëroi deputetët që, brenda tridhjetë ditëve, ta përfundonin konstituimin përmes zgjedhjes së Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit.[24] Pas moszbatimit të këtij Aktgjykimi, më 7 gusht 2025, Gjykata konstatoi se

---

fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/leter_drejtuar_kryetarit_te%20_komunes_se_prizrenit.pdf).

[22] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Urdhër në rastin KO01/09, Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit, 21 qershor 2010, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/urdher_rasti_ko_01_09.pdf).

[23] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin KO79/23, Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, 23 janar 2024, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/ko_79_23_agj_shq.pdf).

[24] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin KO124/25, Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 7 gusht 2025, (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://api.webgjk-ks.org/Custom/4f2913a0-7463-4b56-968d-350b54a65097.pdf).

deputetët nuk e kishin zbatuar Aktgjykimin e 26 qershorit 2025 dhe se edhe Kryesuesi i Seancës Konstituive nuk kishte vepruar në pajtueshmëri me të, duke vlerësuar se veprimet e tij ishin në kundërshtim me nenin 116.1 të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata e urdhëroi shprehimisht Kryesuesin që të vazhdonte me pikën 3 të rendit të ditës së Seancës Konstituive dhe të ftonte përfaqësuesin e grupit më të madh parlamentar që të propozonte kandidatin për Kryetar të Kuvendit, i cili duhej t'i nënshtrohej votimit të hapur. Gjykata urdhëroi gjithashtu që procedura të vazhdonte më pas me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit.

Vlerësimet e IKD-së janë se veprimet e Kryesuesit Avni Dehari pas Aktgjykimit të 7 gushtit 2025 nuk janë në përputhje me detyrimin e përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese. Në vend që të vazhdonte procedurën sipas rendit të ditës dhe t'i kërkonte grupit më të madh parlamentar që të propozonte kandidatin për Kryetar të Kuvendit, Kryesuesi e ndërpreu seancën pasi Lëvizja Vetëvendosje kërkoi kohë shtesë për arritjen e një marrëveshjeje politike. Sipas IKD-së, një kërkesë e tillë nuk e lironte Kryesuesin nga detyrimi për të vazhduar procedurën kushtetuese të përcaktuar shprehimisht nga Gjykata. Po ashtu, fakti që pas 8 gushtit[25] nuk është vazhduar seanca për procedimin e zgjedhjes së Kryetarit dhe më pas të nënkryetarëve, përbën, sipas këtij vlerësimi, mosveprim në kundërshtim me urdhrin konkret të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, për këtë fazë të mosveprimit, Gjykata Kushtetuese nuk ka nxjerrë ende Aktvendim për Mospërmbarim dhe as nuk ka njoftuar Prokurorin e Shtetit.

5. Pasojat e moszbatimit të akgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese

Moszbatimi i një vendimi të Gjykatës Kushtetuese nuk përfundon vetëm me mungesën e përmbushjes së asaj që është urdhëruar në një rast konkret. Për shkak të pozitës së kësaj Gjykate si garantuese e Kushtetutës, dhe aktgjykimeve që ajo nxjerr, pasojat shtrihen në funksionimin e rendit kushtetues, në sigurinë juridike, në besimin e qytetarëve dhe në përgjegjësinë e institucioneve. Komisioni i Venecias kërkon që vendimet në merita të gjykatave kushtetuese të jenë detyruese për të gjitha autoritetet publike dhe të zbatohen në mirëbesim, derisa moszbatimi i tyre përbën shkelje të epërsisë së Kushtetutës.[26]

5.1. Rendi kushtetues

Komisioni i Venecias vlerëson se moszbatimi i vendimeve të gjykatave kushtetuese përbën shkelje të epërsisë së Kushtetutës[27]. CCJE-ja e cilëson zbatimin efektiv të një vendimi gjyqësor detyrues si element themelor të sundimit të ligjit.[28] Përkundër se CCJE-ja e formulon këtë standard për vendimet gjyqësore në përgjithësi, ai përdoret këtu në mënyrë analoge për aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë vështrim, Gjykata Kushtetuese përcakton kufijtë

[25] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kalendari i aktiviteteve – Vazhdimi i Seancës konstituive, 8 gusht 2026, rendi i ditës: "Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit" dhe "Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit", (qasur për herë të fundit më 31 gusht 2026: https://www.kuvendikosoves.org/shq/kalendari/).
[26] Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), *The Updated Rule of Law Checklist*, CDL-AD(2025)002 (Strasburg, 16 dhjetor 2025), par. 149, f. 51.
[27] Po aty.
[28] Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), *Opinion No. 13 (2010) on the Role of Judges in the Enforcement of Judicial Decisions*, CCJE(2010)2 Final, par. 7 dhe përfundimi A, f. 3 dhe 8.

brenda të cilëve mund të ushtrohet pushteti, ndërsa institucionet e tjera kanë detyrimin t'i respektojnë këta kufij. Kur institucioni i obliguar vendos vetë, nëse dhe kur, do ta zbatojë vendimin, fjala përfundimtare mbi kuptimin praktik të Kushtetutës kalon nga Gjykata tek institucioni që është i obliguar ta zbatoj aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Kjo e dëmton ndarjen e pushteteve dhe mekanizmin e kontrollit dhe balancimit. Në kontekstin e rasteve të trajtuara në këtë dokument, përsëritja e moszbatimit krijon rrezik që bindja ndaj Kushtetutës të shndërrohet nga detyrimi juridik në zgjedhje institucionale. Kësisoj, pasoja kryesore nuk është vetëm mosrealizimi i një vendimi, por dobësimi i autoritetit kushtetues të Kushtetutës dhe i rolit të Gjykatës Kushtetuese si garantuese e saj.

5.2. Siguria juridike

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se e drejta për qasje në gjykatë do të ishte iluzive nëse një vendim përfundimtar dhe detyrues do të mund të mbetej pa efekt. Në rastin Okyay dhe të tjerët kundër Turqisë, GjEDNj e ndërlidhi shmangien e ekzekutimit me sundimin të ligjit.[29] Hornsby dhe Okyay nuk trajtojnë aktgjykime kushtetuese, por se ky standard përdoret këtu në mënyrë analoge. Për vendimet kushtetuese, kjo pasojë është edhe më e gjerë. Moszbatimi krijon dy realitete paralele: rregullin juridik të përcaktuar përfundimisht nga Gjykata dhe praktikën institucionale që vazhdon sikur ai rregull të mos ekzistonte. Në një gjendje të tillë, qytetarët dhe institucionet nuk mund ta parashikojnë nëse pasoja juridike do të varet nga vendimi i Gjykatës apo nga vullneti i organit të obliguar për ta zbatuar vendimin e saj. Në Kosovë, kjo e cenon karakterin përfundimtar dhe obligativ të këtyre vendimeve, krijon trajtim të pabarabartë ndërmjet subjekteve në raport me të cilët aktgjykimet zbatohen dhe subjekteve në raport me të cilat akgjykimet nuk zbatohen dhe e vendos realizimin e të drejtave nën ndikimin e vullnetit politik apo institucional.

5.3. Besimi i qytetarëve

CCJE e konsideron zbatimin efektiv të një vendimi gjyqësor detyrues si kusht për ruajtjen e besimit të publikut në autoritetin e gjyqësorit[30]. Meqë ky opinion trajton vendimet gjyqësore në përgjithësi, këtu përdoret në mënyrë analoge për aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese. Rekomandimi Rec(2003)16 kërkon që autoritetet administrative t'i zbatojnë vendimet gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm dhe që, në rast të moszbatimit, të ekzistojnë procedura efektive, përfshirë urdhrat detyrues dhe gjobat shtrënguese. Po ashtu, ai parasheh përgjegjësinë e autoritetit dhe mundësinë që zyrtarët përgjegjës të mbajnë përgjegjësi individuale disiplinore, civile ose penale kur refuzojnë apo neglizhojnë zbatimin[31]. Rekomandimi ka si fushë vendimet administrative dhe gjyqësore në të drejtën administrative, megjithëse në mënyrë analoge, këto standarde mund të përdoren edhe për vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

---

[29] Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, aktgjykim i 19 marsit 1997, par. 40, https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-58020; Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Okyay dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 36220/97, aktgjykim i 12 korrikut 2005, par. 72–74, https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-69672.
[30] CCJE, *Opinion No. 13 (2010)*, preambula.
[31] Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, Rekomandimi Rec(2003)16 për ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore në fushën e së drejtës administrative, miratuar më 9 shtator 2003, shtojca, II.1(a)–(c).

Një procedurë dhe një vendim që nuk prodhojnë rezultat e bëjnë mbrojtjen juridike formale, ndërsa qytetari nuk ka arsye të besojë se përdorimi i mjeteve juridike do t'i ndryshojë realisht veprimet e institucioneve publike. Një studim eksperimental tregon se mbështetja e qytetarëve për politikat kundër COVID-19 zvogëlohet kur gjykata vë në dyshim kushtetutshmërinë e tyre, ndërsa shkalla e këtij ndikimi varet nga besimi që qytetarët kanë në gjykatë[32]. Në Kosovë, moszbatimi i përsëritur rrezikon të krijojë bindjen se vendimet kushtetuese kanë efekt vetëm kur përputhen me interesin e institucionit të obliguar. Kjo e dëmton jo vetëm besimin në Gjykatën Kushtetuese, por edhe besimin në rendin juridik dhe në barazinë e institucioneve dhe të qytetarëve para Kushtetutës.

5.4. Përgjegjësia institucionale

Rekomandimi Rec(2003)16 parashikon që autoritetet administrative t'i zbatojnë vendimet gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm dhe, kur refuzojnë ose neglizhojnë zbatimin, mundësinë që zyrtarët përgjegjës të mbajnë përgjegjësi disiplinore, civile ose penale. CCJE-ja, nga ana tjetër, përmend urdhra gjyqësorë, masa të tërthorta shtrënguese dhe mbledhje e raportim të rregullt të të dhënave mbi zbatimin.[33] Meqë këto burime trajtojnë vendime administrative dhe gjyqësore në përgjithësi, këtu përdoren në mënyrë analoge si orientim për aktgjykimet kushtetuese. Në mungesë të një përgjegjësie të qartë, detyrimi mund të shpërndahet ndërmjet institucioneve dhe zyrtarëve deri në atë masë sa askush të mos mbajë përgjegjësi reale. Rastet e trajtuara në këtë dokument tregojnë se mungesa e pasojave efektive mund të rrezikoj normalizimin e mosveprimin institucional në drejtim të zbatimit të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, përgjegjësia duhet të individualizohet: ajo mund të lidhet vetëm me zyrtarin që ka detyrim juridik të qartë, kompetencë dhe mundësi reale për zbatim, si dhe që refuzon ose nuk vepron me dashje dhe pa arsyetim objektiv.

6. Standardet ndërkombëtare dhe praktikat krahasuese

6.1. Standardet ndërkombëtare

Burimet e cituara më poshtë nuk kanë të njëjtën fushë: Komisioni i Venecias dhe CCJE-ja, në këto pjesë, trajtojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore në përgjithësi, por të cilat në mënyrë analoge mund të trajtohen edhe në kontekst të zbatimit të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese. Komisioni i Venecias e përfshin ndër elementet e sundimit të ligjit ekzistencën e një gjyqësori të pavarur, vendimet e të cilit zbatohen në mënyrë efektive[34]. CCJE-ja e cilëson

[32] Shih pwr mw tepwr: Jerg Gutmann, Roee Sarel dhe Stefan Voigt, "Measuring Constitutional Loyalty," *Public Choice* 205 (2025).
[33] Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, Rekomandimi Rec(2003)16, shtojca, II.1(a)–(c); CCJE, *Opinion No. 13 (2010)*, par. 18–23.
[34] Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), *The Updated Rule of Law Checklist*, CDL-AD(2025)002 (Strasburg, 16 dhjetor 2025), par. 12.

zbatimin efektiv të një vendimi detyrues si element themelor të sundimit të ligjit dhe si kusht për besimin e publikut në autoritetin e gjyqësorit.[35]

Ky detyrim merr peshë edhe më të madhe kur bëhet fjalë për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Përderisa vendimi i një gjykate të rregullt zgjidh një kontest konkret, vendimi kushtetues mbron njëkohësisht epërsinë e Kushtetutës, kufijtë e pushtetit institucional dhe funksionimin e sistemit të kontrollit dhe balancit. Komisioni i Venecias thekson se vendimet në merita të Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë detyruese për të gjitha autoritetet publike dhe të zbatohen në mirëbesim. Moszbatimi i tyre përbën shkelje të epërsisë së Kushtetutës. Kontroll lista e përdor si kriter vlerësimi nëse Kuvendi dhe ekzekutivi marrin parasysh vendimet dhe arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese dhe nëse i adresojnë, brenda një afati të arsyeshëm zbrazëtitë ligjore ose rregullative të identifikuara nga Gjykata.[36]

Zbatimi është, rrjedhimisht, pjesë e sigurisë juridike dhe jo një çështje teknike që fillon vetëm pasi gjykata e ka përfunduar punën. Qytetari duhet të ketë mundësi të mbështetet në efektin përfundimtar dhe real të një vendimi, ndërsa institucionet nuk mund ta trajtojnë atë si rekomandim. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar se ekzekutimi i një aktgjykimi është pjesë përbërëse e 'gjykimit' për qëllimet e nenit 6 të Konventës.[37] Hornsby trajton një vendim të gjykatës së rregullt ndërkaq standardi i tij përdoret këtu në mënyrë analoge dhe vetëm për parimin e efektivitetit të vendimit. CCJE-ja thekson se një autoritet jogjyqësor nuk mund ta ndryshojë përmbajtjen e një vendimi detyrues. Pezullimi mund të bëhet vetëm me një vendim tjetër gjyqësor, ndërsa shtyrja vetëm mbi baza të përcaktuara me ligj dhe nën vlerësimin e gjyqtarit[38]. Meqë opinioni i referohet vendimeve gjyqësore në përgjithësi, ky standard qartësisht aplikohet edhe në raport me vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Megjithatë, burimet orientuese të Këshillit të Evropës nuk e reduktojnë sigurimin e zbatimit në një masë të vetme. Ato përmendin një sistem në të cilin autoriteti dhe procedura për ekzekutim janë të përcaktuara, zbatimi është i shpejtë e efektiv dhe sigurohen burimet e nevojshme. Masat e përmendura përfshijnë: zbatim brenda një afati të arsyeshëm; procedurë të përcaktuar dhe, kur vonesa mund të shkaktojë dëm të pakthyeshëm, procedurë të përshpejtuar; urdhra gjyqësorë dhe gjoba shtrënguese; kontroll gjyqësor; kompensim dhe kamatë; si dhe mbledhje e raportim të të dhënave mbi zbatimin[39]. Të gjitha burimet e përdorura në këtë paragraf trajtojnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ose administrative në përgjithësi; për aktgjykimet kushtetuese përdoren këtu vetëm në mënyrë analoge si orientim institucional. Rekomandimi Rec(2003)16, Handbook-u i Këshillit të Evropës dhe CCJE-ja përmendin gjithashtu procedura

---

[35] Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), *Opinion No. 13 (2010) on the Role of Judges in the Enforcement of Judicial Decisions*, CCJE(2010)2 Final, par. 7,.
[36] Komisioni i Venecias, *The Updated Rule of Law Checklist*, kriteri G.4 dhe par. 149.
[37] Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, aktgjykim i 19 marsit 1997, par. 40.
[38] CCJE, *Opinion No. 13 (2010)*, par. 12–13.
[39] Këshilli i Evropës, *The Administration and You: A Handbook* (Strasburg: Council of Europe, 2018), Parimi 21, f. 55–56; Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Rec(2003)16 për ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore në fushën e së drejtës administrative, miratuar më 9 shtator 2003, shtojca, II.1(a)–(c) dhe II.2(a)–(d), https://search.coe.int/cm?i=09000016805df14f; CCJE, Opinion No. 13 (2010), par. 16–23 dhe 34–36, https://rm.coe.int/168046914c.

për ekzekutimin kundër autoriteteve publike dhe mundësinë e përgjegjësisë individuale disiplinore, civile ose penale të zyrtarëve të cilëve u atribuohet refuzimi ose vonesa e zbatimit.[40]

Pikërisht këtu duhet bërë dallimi ndërmjet detyrimit për të siguruar zbatimin dhe detyrimit për ta kriminalizuar çdo moszbatim. Standardet e cituara trajtojnë kryesisht ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në përgjithësi, përfshirë vendimet kundër institucioneve publike. Ato nuk vendosin një rregull të përgjithshëm sipas të cilit çdo vonesë ose dështim duhet të përbëjë vepër penale, e as nuk kërkojnë domosdoshmërisht krijimin e një vepre të posaçme për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Edhe kur përmendet përgjegjësia penale, ajo paraqitet krahas përgjegjësisë disiplinore dhe civile, si një prej mjeteve që shteti mund ta përdorë në varësi të natyrës, peshës dhe shkaqeve të moszbatimit. Në një shtet të sundimit të ligjit, pikënisja duhet të jetë zbatimi vullnetar dhe ex officio nga autoritetet publike. Vetë ideja se një organ shtetëror mund të refuzojë t'i bindet një vendimi gjyqësor, sipas CCJE-së, e cenon parimin e epërsisë së ligjit.[41] Meqë paragrafët e CCJE-së trajtojnë vendimet gjyqësore kundër organeve publike në përgjithësi, parimi i zbatimit ex officio përdoret këtu në mënyrë analoge për aktgjykimet kushtetuese.

Përdorimi i së drejtës penale duhet, për këtë arsye, të mbetet përjashtim. Jareborg e trajton nevojën dhe alternativat më pak ndërhyrëse si argumente relevante për kriminalizimin, por e dallon parimin ultima ratio nga subsidiariteti dhe vë në dyshim funksionin normativ të pavarur të formulimit të tij të zakonshëm[42]. Dokumenti i Komisionit Evropian e quan të drejtën penale mjet të fundit dhe kërkon që, para kriminalizimit, të shqyrtohet nëse masat administrative ose civile mund ta sigurojnë mjaftueshëm qëllimin; ai kërkon gjithashtu domosdoshmëri, proporcionalitet dhe përkufizim të qartë të sjelljes penale.[43] Vetëm fakti se një sjellje është e papranueshme institucionalisht nuk mjafton vetvetiu për ta shndërruar atë në vepër penale; ky është përfundim i këtij punimi.

Në rrethana normale, nuk do të duhej të ishte e nevojshme që një shtet ta përdorë dënimin penal për t'i bindur institucionet e veta që ta zbatojnë Kushtetutën, si në rastin konkret, aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, rastet e trajtuara më sipër në këtë dokument tregojnë se në Kosovë moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të shihet më vetëm si incident i izoluar. Përsëritja e rasteve, kohëzgjatja e moszbatimit dhe mungesa e pasojave efektive krijojnë bazë për të vlerësuar se mekanizmat ekzistues nuk kanë qenë të mjaftueshëm. Në këtë kontekst, ndërhyrja penale, fatkeqësisht, të arsyetohet si masë e fundit, jo si zgjidhje e zakonshme.

Një ndërhyrje e tillë duhet të jetë e ngushtë dhe e ndërtuar me garanci të qarta. Ajo nuk duhet të përfshijë pamundësinë objektive për zbatim, nevojën reale për masa përgatitore, paqartësinë

---

[40] Këshilli i Evropës, *The Administration and You: A Handbook*, Parimi 21, f. 55–56; Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Rec(2003)16, shtojca, II.1(b)–(c); CCJE, Opinion No. 13 (2010), par. 31–34.
[41] CCJE, *Opinion No. 13 (2010)*, par. 31–36, f. 5.
[42] Shih për më shumë: Nils Jareborg, "Criminalization as Last Resort (Ultima Ratio)," *Ohio State Journal of Criminal Law* 2 (2005): 521–534.
[43] Komisioni Evropian, *Towards an EU Criminal Policy: Ensuring the Effective Implementation of EU Policies through Criminal Law*, COM(2011) 573 final (Bruksel, 20 shtator 2011), f. 6–7.

e arsyeshme rreth mënyrës së ekzekutimit apo një vonesë që është e justifikuar me rrethanat konkrete. Përgjegjësia penale duhet të lidhet vetëm me refuzimin ose mosveprimin e qëllimshëm dhe të pajustifikuar të një personi zyrtar të identifikueshëm, i cili ka detyrim të qartë juridik, kompetencë dhe mundësi reale për ta zbatuar vendimin. Kështu, standardet ndërkombëtare nuk e imponojnë kriminalizimin, por as nuk e përjashtojnë atë: ato kërkojnë që vendimet kushtetuese të zbatohen efektivisht dhe i lejojnë shtetit të zgjedhë një reagim më të ashpër kur masat e tjera kanë dështuar, me kusht që të respektohen ligjshmëria, domosdoshmëria dhe proporcionaliteti. Rastet si më sipër, tregojnë se në Kosovë, tanimë janë plotësuar kushtet për të zgjedhur një masë të tillë të zbatimin e aktgjyukimeve të Gjykatës Kushtetuese, duke kriminalizuar moszbatimin e tyre.

6.2. Praktika evropiane

Studimi krahasues i Naglierit shqyrton ekzekutimin e vendimeve të gjykatave kushtetuese në Austri, Gjermani, Spanjë dhe Itali. Në këtë analizë, autori merr parasysh legjislacionin dhe interpretimin gjyqësor, nocionin e ekzekutimit, llojet e vendimeve që mund t'i nënshtrohen ekzekutimit, subjektin të cilit i janë atribuuar kompetencat e ekzekutimit dhe shtrirjen e kompetencave të gjykatës kushtetuese, duke sistematizuar mbi këtë bazë modele të ekzekutimit kushtetues.[44] Studimi nuk ndërton një tipologji të veprave penale për moszbatim; prandaj, prej tij nuk nxirret përfundimi se kriminalizimi mungon në të gjitha juridiksionet e shqyrtuara. Si përfundim i këtij punimi, dhe jo si pohim i autorit të cituar, modelet e trajtuara më poshtë tregojnë se kriminalizimi i posaçëm nuk paraqitet si mekanizëm i përbashkët.

Në Gjermani, vendimet e Gjykatës Kushtetuese Federale janë detyruese për organet kushtetuese, gjykatat dhe të gjitha autoritetet publike. Për më tepër, Gjykata mund të përcaktojë se kush duhet ta ekzekutojë vendimin dhe mënyrën e ekzekutimit.[45] Në Austri, Kushtetuta e rregullon drejtpërdrejt ekzekutimin: disa vendime ekzekutohen nga gjykatat e rregullta, ndërsa ekzekutimi i vendimeve të tjera i takon Presidentit Federal, përmes organeve federale ose të landeve.[46] Në Francë, vendimet e Këshillit Kushtetues janë përfundimtare dhe detyruese për pushtetet publike dhe për të gjitha autoritetet administrative e gjyqësore.[47] Kështu, nga analiza krahasuese shihet se këto sisteme mbështeten në bindjen se vendimi kushtetues duhet të zbatohet si pasojë e drejtpërdrejtë e rendit kushtetues, pa qenë e nevojshme që zyrtari publik të kërcënohet paraprakisht me dënim penal.

Spanja paraqet një model më të fuqishëm të ekzekutimit institucional. Gjykata Kushtetuese mund të përcaktojë subjektin dhe masat e ekzekutimit, të kërkojë ndihmën urgjente të autoriteteve publike, të shqiptojë gjoba shtrënguese, të pezullojë përkohësisht zyrtarët përgjegjës dhe të urdhërojë ekzekutim zëvendësues. Vetëm si njëra nga masat e mundshme,

---

[44]Shih për më tepër: Giuseppe Naglieri, "La ejecución de las resoluciones de los tribunales constitucionales. Sujetos, formas, modelos y categorías en el Derecho comparado," *Teoría y Realidad Constitucional*, nr. 53 (2024): 595–640.
[45]Gjermani, Act on the Federal Constitutional Court (Bundesverfassungsgerichtsgesetz), §§ 31(1) dhe 35, versioni i përditësuar deri më 22 dhjetor 2025, https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_bverfgg/.
[46]Austri, Bundes-Verfassungsgesetz, neni 146.
[47]Francë, Constitution du 4 octobre 1958, neni 62.

Gjykata mund t'ia përcjellë çështjen organit kompetent për vlerësimin e përgjegjësisë penale.[48] Pra, edhe në një sistem që ka paraparë masa të forta, reagimi penal nuk është mekanizmi i parë, por mundësi plotësuese pasi të jetë konstatuar moszbatimi.

Raporti vjetor 2024 i Komisionit Evropian për sundimin e ligjit shqyrton të 27 shtetet anëtare në katër fusha, përfshirë sistemet e drejtësisë dhe kontrollet e balancat institucionale; raporti horizontal nuk e identifikon mosekzekutimin sistematik të vendimeve të gjykatave kushtetuese si problem horizontal të përbashkët.[49] Ky konstatim kufizohet vetëm në çështjet që identifikon raporti horizontal: ai nuk provon mungesën e rasteve individuale ose të problemeve në kapituj të veçantë kombëtarë. Vlerësimi nëse fenomeni arrin nivel strukturor në një shtet të caktuar kërkon burime të posaçme kombëtare.

Kjo gjendje ndërlidhet edhe me kulturën kushtetuese. Respektimi i Kushtetutës nuk varet vetëm nga ekzistimi i sanksionit, por edhe nga mjedisi institucional dhe nga bindja e akterëve publikë se Kushtetuta dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese janë detyruese. Kultura kushtetuese nuk e zëvendëson ligjin, por shpjegon pse, në shtete të caktuara, vendimet zbatohen pa pasur nevojë për aktivizimin e përgjegjësisë penale.

6.3. Praktika rajonale

Në vendet e rajonit paraqitet një gjendje tjetër. Zgjidhjet nuk janë të njëjta, por në disa prej tyre ligjvënësi e ka parë të nevojshme që moszbatimin e vendimeve të gjykatës kushtetuese ta inkriminojë shprehimisht si vepër penale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për Kosovën, sepse tregon dallimin ndërmjet një norme të përgjithshme për moszbatimin e vendimeve gjyqësore dhe një norme që, pa lënë hapësirë për analogji, e përfshin shprehimisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Maqedonia e Veriut paraqet modelin më të afërt. Neni 112(3) i Kushtetutës përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme. Neni 377(2) i Kodit Penal sanksionon me gjobë ose burgim deri në tre vjet personin zyrtar ose përgjegjës që refuzon të ekzekutojë një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, të cilin është i detyruar ta ekzekutojë. Paragrafi 3 e rregullon veçmas refuzimin për të ekzekutuar një vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe parashikon burgim nga një deri në pesë vjet. Teksti i konsoliduar i publikuar në ËIPO Lex parashikon në paragrafin 4 se, kur vepra shkakton shkelje më të rëndë të të drejtave të tjetrit ose dëm të konsiderueshëm pasuror, dënimi për veprat nga paragrafët 1 dhe 2 është burgim nga një deri në pesë vjet, ndërsa për veprën nga paragrafi 3 është burgim nga një deri në dhjetë vjet.[50]

---

[48]Spanjë, Ley Orgánica 2/1979, de 3 de octubre, del Tribunal Constitucional, nenet 87 dhe 92, tekst i konsoliduar, https://www.boe.es/buscar/act.php?id=BOE-A-1979-23709.
[49]Komisioni Evropian, 2024 Rule of Law Report, raport horizontal dhe kapitujt për 27 shtetet anëtare, 24 korrik 2024.
[50]Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 112(3); Kodi Penal i Republikws sw Maqedonisw sw Veriut, neni 377(2)–(4).

Rëndësia e këtij formulimi qëndron në faktin se legjislacioni maqedonas nuk e ka lënë përfshirjen e Gjykatës Kushtetuese në kuadër të nocionit të përgjithshëm "gjykatë", dallim i cili është i dukshëm në sistemin kushtetues kosovar, i cili dallim është bërë në kapitujt paraprak. Përkundrazi, e ka ndarë vendimin e gjykatës së rregullt nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Kjo dispozitë është zbatuar edhe në praktikë.

Në Shqipëri, neni 132 i Kushtetutës përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Neni 320 i Kodit Penal sanksionon fshehjen, tjetërsimin, konsumimin, dëmtimin ose shkatërrimin e sendeve mbi të cilat është marrë një vendim gjyqësor, ose veprime të tjera me qëllim mosekzekutimin e tij; neni 320/a sanksionon mosekzekutimin pa shkaqe të përligjura të vendimit penal ose civil nga punonjësi i ngarkuar me ekzekutimin.[51] Në këto dispozita nuk përmendet shprehimisht Gjykata Kushtetuese.

Bosnja dhe Hercegovina ka zgjedhur një rregullim të shprehur dhe të ashpër. Neni 239 i Kodit Penal sanksionon personin zyrtar ose përgjegjës që nuk zbaton, nuk ekzekuton ose pengon zbatimin e vendimit përfundimtar dhe detyrues të Gjykatës Kushtetuese, përfshirë masat e përkohshme. Dënimi i paraparë është burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet, krahas ndalimit të ushtrimit të funksionit dhe pasojave të tjera juridike.[52]

Në përfundim, praktika krahasuese paraqet tri modele. Demokracitë e konsoliduara evropiane mbështeten kryesisht në fuqinë detyruese të vendimit dhe mekanizmat institucionalë të ekzekutimit. Shqipëria ka norma të përgjithshme për vendimet gjyqësore, pa e përmendur shprehimisht Gjykatën Kushtetuese. Maqedonia e Veriut dhe Bosnja e Hercegovina e kanë kriminalizuar shprehimisht moszbatimin e vendimeve kushtetuese. Për Kosovën, argumenti nuk duhet të jetë se kriminalizimi paraqet standardin evropian. Ai nuk e paraqet një standard të tillë. Argumenti qëndron në faktin se, kur mekanizmat e zakonshëm dhe kultura e respektimit të Kushtetutës nuk kanë siguruar zbatimin, vendet e rajonit kanë përdorur edhe përgjegjësinë penale si masë përjashtuese.

7. Nevoja për ndryshimin e Kodit Penal

Në një rend kushtetues funksional, zbatimi i aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese duhet të jetë pasojë e natyrshme e detyrueshmërisë së Kushtetutës. Institucionet publike nuk duhet të kenë nevojë për kërcënimin me dënim penal që t'i zbatojnë vendimet e organit që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Për këtë arsye, standardet ndërkombëtare nuk e paraqesin kriminalizimin si mekanizmin e zakonshëm për sigurimin e zbatimit. Ato nisen nga zbatimi në mirëbesim, nga kultura kushtetuese dhe nga funksionimi i mekanizmave institucionalë, disiplinorë, administrativë e civilë. E drejta penale mbetet mjet i fundit dhe përdorimi i saj duhet të arsyetohet vetëm kur mjetet e tjera nuk kanë qenë të mjaftueshme.

---

[51]Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 132, https://president.al/wp-content/uploads/2023/09/Kushtetuta-e-Republikes-se-Shqiperise.pdf; Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, nenet 320 dhe 320/a, tekst i përditësuar edhe me ligjin nr. 8/2026, datë 28 janar 2026, https://qbz.gov.al/share/_YCvl02dROybrYpg2hNERg.
[52]Bosnjë dhe Hercegovinë, Kodi Penal, neni 239(1), (4) dhe (5), ndryshimi i shpallur me vendimin e Përfaqësuesit të Lartë më 1 korrik 2023 dhe në fuqi nga 2 korriku 2023, Office of the High Representative, "Decision Enacting the Law on Amendments to the Criminal Code of Bosnia and Herzegovina.

Megjithatë, ky parim nuk mund të shkëputet nga gjendja konkrete në një shtet. Rastet e trajtuara në këtë dokument tregojnë se në Kosovë moszbatimi i aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk ka mbetur në nivelin e një rasti të vetëm apo të një vonese të rastësishme. Përsëritja e rasteve, kohëzgjatja e moszbatimit dhe mungesa e pasojave efektive tregojnë se detyrueshmëria kushtetuese, e vetme, nuk ka mjaftuar gjithmonë për ta siguruar zbatimin. Në këto rrethana, mbështetja vetëm në pritjen që institucionet do ta zhvillojnë vetvetiu kulturën e nevojshme kushtetuese nuk ofron përgjigje të mjaftueshme ndaj një problemi që tashmë është shfaqur në praktikë.

Kodi Penal e sanksionon mosekzekutimin e urdhrit, vendimit ose aktgjykimit të plotfuqishëm të ndonjë gjykate të Republikës së Kosovës. Kjo normë mbulon vendimet e gjykatave të rregullta, por nuk e përfshin në mënyrë të qartë Gjykatën Kushtetuese. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e pushtetit unik gjyqësor, por organ i pavarur për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Për këtë arsye, nocioni i përgjithshëm "gjykatë" në një dispozitë penale nuk mund të zgjerohet automatikisht edhe ndaj saj. Një interpretim i tillë do të ishte veçanërisht problematik për shkak të parimit të ligjshmërisë, kërkesës që vepra penale të përcaktohet qartë dhe ndalimit të analogjisë në dëm të të pandehurit.

Kësisoj, nevoja për ndryshimin e Kodit Penal nuk buron nga mungesa e një norme të përgjithshme për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Ajo buron nga një hendek i veçantë normativ lidhur me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese. Përmendja e shprehur e këtyre aktgjykimeve do ta hiqte paqartësinë aktuale, do ta bënte përgjegjësinë të parashikueshme dhe do të evitonte që një çështje penale të varet nga interpretimi zgjerues i nocionit "gjykatë". Në këtë mënyrë, ndryshimi do të shërbente njëkohësisht edhe për mbrojtjen e autoritetit të Gjykatës Kushtetuese, edhe për respektimin e garancive të së drejtës penale.

Ndërhyrja e propozuar duhet të jetë e kufizuar. Qëllimi nuk është që çdo vonesë, paqartësi ose vështirësi në zbatim të trajtohet si vepër penale. Përgjegjësia mund të lidhet vetëm me personin zyrtar ose përgjegjës që ka detyrim juridik të qartë, kompetencë dhe mundësi reale për zbatim, por që, me dashje dhe pa arsye objektive, refuzon të ose nuk ndërmerr veprimet e nevojshme. Pamundësia objektive, nevoja reale për masa përgatitore, mungesa e kompetencës dhe vonesa e arsyeshme nuk duhet të përfshihen në fushën e kriminalizimit. Po ashtu, përgjegjësia duhet të individualizohet dhe nuk mund të atribuohet në mënyrë abstrakte.

Në këtë kuptim, ndryshimi i Kodit Penal nuk duhet të kuptohet si zëvendësim i kulturës kushtetuese, i përgjegjësisë politike apo i mekanizmave institucionalë të zbatimit. Ai duhet të funksionojë si garanci plotësuese për rastet më të rënda, kur refuzimi është i qëllimshëm dhe mjetet e tjera nuk kanë prodhuar efekt. Vetë ekzistimi i normës synon para së gjithash parandalimin dhe zbatimin vullnetar, e jo shtimin e procedurave penale.

Përfundimisht, në rrethanat e Kosovës, ruajtja e gjendjes aktuale nuk ofron siguri të mjaftueshme se aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese do të zbatohen në secilin rast. Rastet e evidentuara në këtë dokument krijojnë bazë të mjaftueshme për një reagim më të qartë juridik. Për këtë arsye, plotësimi i Kodit Penal, përmes përfshirjes së shprehur të moszbatimit të qëllimshëm dhe të pajustifikuar të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, paraqitet si masë e

nevojshme dhe përjashtuese për mbrojtjen e epërsisë së Kushtetutës, sigurisë juridike dhe përgjegjësisë institucionale.

8. Ndikimet e pritshme

Ndikimet e propozimit duhet të vlerësohen në mënyrë reale dhe në raport me natyrën subsidiare të së drejtës penale. Qëllimi i ndërhyrjes nuk është që zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të mbështetet parimisht në ndjekje penale. Përkundrazi, efekti i synuar është që ekzistimi i një përgjegjësie të qartë ta parandalojë refuzimin e qëllimshëm dhe ta nxisë zbatimin vullnetar e me kohë. Në këtë kuptim, suksesi i masës nuk do të matet me numrin e procedurave penale, por me zvogëlimin e rasteve të moszbatimit.

8.1. Ndikimet në sundimin e ligjit

Dokumenti i Komisionit Evropian e trajton të drejtën penale si mjet të fundit dhe kërkon domosdoshmëri, proporcionalitet, shqyrtim të masave administrative ose civile dhe përkufizim të qartë të sjelljes së ndaluar[53]. Në këtë rast, vlera që mbrohet është zbatimi efektiv i Kushtetutës dhe i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Një normë e kufizuar në refuzimin e qëllimshëm dhe të pajustifikuar do të përcillte mesazhin se institucionet nuk kanë diskrecion për të zgjedhur nëse do t'i binden Kushtetutës. Kjo pritet ta forcojë sundimin e ligjit duke e lidhur ushtrimin e pushtetit publik me pasoja juridike reale. Megjithatë, efekti mund të jetë i kundërt nëse dispozita formulohet gjerësisht ose zbatohet në mënyrë selektive. Prandaj, ndikimi pozitiv varet nga një përkufizim i saktë, zbatim i pavarur dhe respektim i plotë i parimeve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.

8.2. Ndikimet në funksionimin e institucioneve

Rekomandimi Rec(2003)16 dhe CCJE-ja kërkojnë ose rekomandojnë, sipas fushës së secilit dokument, përcaktimin e autoritetit përgjegjës dhe të procedurës, zbatimin brenda një afati të arsyeshëm, urdhra e masa shtrënguese, si dhe të dhëna e raportim mbi ekzekutimin.[54] Këto burime trajtojnë vendime administrative dhe gjyqësore në përgjithësi; në këtë paragraf përdoren në mënyrë analoge vetëm si orientim institucional për aktgjykimet kushtetuese. Për këtë arsye, ndikimi institucional i ndryshimit të propozuar duhet të jetë më i gjerë se vetë procedura penale. Ekzistimi i një detyrimi të saktë pritet t'i nxisë institucionet që, menjëherë pas pranimit të vendimit, të përcaktojnë njësinë dhe zyrtarin përgjegjës, masat e nevojshme, afatin dhe mënyrën e raportimit. Kjo mund ta përmirësojë koordinimin dhe ta zvogëlojë mundësinë që përgjegjësia të bartet nga një organ tek tjetri. Në të njëjtën kohë, norma duhet të shmangë administrimin mbrojtës dhe frikën nga përgjegjësia për çdo vonesë. Për këtë qëllim, duhet të dallohen qartë refuzimi nga veprimet përgatitore të arsyeshme, mungesa e

---

[53] Komisioni Evropian, *Towards an EU Criminal Policy: Ensuring the Effective Implementation of EU Policies through Criminal Law*, COM(2011) 573 final (Bruksel, 20 shtator 2011), f. 6–7;
[54] Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, Rekomandimi Rec(2003)16 për ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore në fushën e së drejtës administrative, miratuar më 9 shtator 2003, shtojca, II.1(a)–(c); Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), *Opinion No. 13 (2010) on the Role of Judges in the Enforcement of Judicial Decisions*, CCJE(2010)2 Final, par. 16 dhe 18–23.

kompetencës dhe pamundësia objektive. Ndërhyrja penale duhet të jetë pjesë plotësuese e një mekanizmi më të gjerë institucional të zbatimit.

8.3. Ndikimet në zbatimin e Kushtetutës

Komisioni i Venecias kërkon që vendimet në merita të gjykatave kushtetuese të jenë detyruese për të gjitha autoritetet publike, të zbatohen në mirëbesim dhe të mos neutralizohen përmes nxjerrjes së akteve me përmbajtje të njëjtë.[55] Në Kosovë, Kodi Penal e sanksionon mosekzekutimin e vendimeve të "ndonjë gjykate të Republikës së Kosovës", por nuk e përmend shprehimisht Gjykatën Kushtetuese. Për shkak të pozitës së saj të veçantë jashtë sistemit të gjykatave të rregullta, përfshirja e saj përmes interpretimit zgjerues do të ishte problematike. Vetë Kodi kërkon që përkufizimi i veprës penale të jetë i saktë dhe ndalon interpretimin sipas analogjisë, derisa GjEDNj kërkon që norma penale të jetë e qasshme dhe e parashikueshme dhe ndalon interpretimin zgjerues, përfshirë analogjinë, në dëm të të akuzuarit.[56] Përmendja e shprehur e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese do ta mbyllte këtë paqartësi dhe do ta bënte detyrimin penal të parashikueshëm. Efekti i pritshëm është parandalimi i refuzimit dhe i përpjekjeve për ta anashkaluar vendimin, duke kufizuar përgjegjësinë vetëm në pasojën detyruese që mund të identifikohet qartë nga dispozitivi i aktgjykimit, i cili elaborohet në arsyetimin e tij.

8.4. Ndikimet në besimin e qytetarëve

CCJE e lidh zbatimin efektiv të vendimeve detyruese me besimin e publikut në autoritetin e gjyqësorit. Meqë opinioni flet për vendimet gjyqësore në përgjithësi, ky standard përdoret këtu në mënyrë analoge për aktgjykimet kushtetuese.[57] Një mekanizëm që siguron përgjegjësi të barabartë dhe zbatim real mund ta përforcojë bindjen se vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk janë deklarata pa pasoja dhe se asnjë institucion nuk është mbi Kushtetutën. Megjithatë, vetëm kriminalizimi nuk e krijon këtë besim. Procedurat selektive, të vonuara ose të politizuara do të mund ta thellonin mosbesimin. Për këtë arsye, ndikimi pozitiv duhet të mbështetet me raportim publik mbi efektivitetin e zbatimit, vonesat dhe shkaqet e tyre, si dhe metodat e ekzekutimit.[58] Po ashtu, organet e ndjekjes duhet t'i arsyetojnë vendimet e tyre. Besimi do të rritet para së gjithash kur qytetarët shohin se vendimet zbatohen, derisa sanksioni penal mbetet garanci plotësuese për rastet e refuzimit të qëllimshëm.

---

[55] Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), *The Updated Rule of Law Checklist*, CDL-AD(2025)002 (Strasburg, 16 dhjetor 2025), par. 149, f. 51, https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD%282025%29002-e.
[56] Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës (i konsoliduar), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, publikuar më 6 shkurt 2026, nenet 2(3); Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Kokkinakis kundër Greqisë*, nr. 14307/88, aktgjykim i 25 majit 1993, par. 52.
[57] CCJE, *Opinion No. 13 (2010)*, par. 7, f. 3;
[58] CCJE, *Opinion No. 13 (2010)*, par. 22–23, f. 4,. CCJE rekomandon përfshirjen e të dhënave mbi ekzekutimin në informacionin për publikun dhe raportim të rregullt mbi efektivitetin e ekzekutimit, vonesat e shkaqet e tyre dhe metodat e ekzekutimit.

